



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit
P-108
Prishtinë, më 21 qershor 2010, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 21 QERSHOR 2010

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Ibrahim Gashi, Naim Maloku, Nexhat Daci dhe Etem Arifi, anëtarë të Kryesisë;

Nga grupet parlamentare: Ramë Buja, Ismet Beqiri, Ibrahim Makolli, Lulzim Zeneli, Xhezair Murati dhe Branislav Grbiq.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Mehmet Hajrizi dhe Eshref Vishi;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Selman Ymeri dhe Shefki Shoshaj.

Nga ZCN: Blerta Bejtullahu;
Nga OSBE: Floriana Shala, dhe
Nga NDI, Shefki Kastrati.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje.

Ai propozoi edhe tri pika shtesë:

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike,
2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tatimin e normës së akcizës në Kosovë,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Administratën Tatimore të Kosovës.

Kryesia u pajtua me propozimin e kryetarit.

Në vazhdim, Kryesia i zhvilloi punimet me këtë

R e n d d i t e

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 15 qershor 2010,
2. Propozimi i rendit të ditës për mbledhjen plenare, më 25 qershor 2010,
3. Shqyrtimi i mocioneve, të rekomandimeve dhe të kërkesave.

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 15 qershor 2010

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 15 qershor 2010, u miratua pa vërejtje.

2. Propozimi i rendit të ditës për mbledhjen plenare, më 25 qershor 2010

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që materialet e propozuara të shqyrtohen në tri mbledhjet e ardhshme të Kuvendit që do të mbahen më 25 qershor 2010, më 1 korrik 2010 dhe më 8 korrik 2010, si në vijim:

1. Mbledhja plenare, më 25 qershor 2010

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme plenare,
3. Koha për pyetje parlamentare,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ripranim,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për dokumentet e udhëtimit,
6. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor lidhur me Projektligjin për mbrojtjen e natyrës,
7. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurën administrative,
8. Shqyrtimi i Rekomandimit lidhur me nominimin e anëtarëve për Bordin për Ankesa të Mediave (BAM) nga Gjykata Supreme e Kosovës.

2. Mbledhja plenare, më 1 korrik 2010

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme plenare,
3. Koha për pyetje parlamentare,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tatimin e normës së akcizës në Kosovë,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Administratën Tatimore të Kosovës.

3. Mbledhja plenare, më 8 korrik 2010

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mëparshme plenare,
3. Koha për pyetje parlamentare,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2010,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ujitjen e tokave bujqësore,
6. Shqyrtimi i dytë i Projekt-Kodit të drejtësisë për të mitur,
7. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Rregullatorit për Ujëra e Mbeturina, për vitin 2009,
8. Shqyrtimi i Raportit për funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm në Sektorin Publik të Kosovës, për vitin 2009,
8. Shqyrtimi i Propozim – vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e kryetarit dhe të anëtarëve të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik.

Kryesia u dakordua që këto agjenda mund të plotësohen me propozime dhe rekomandime të komisioneve parlamentare, të cilat i plotësojnë kushtet për procedim në mbledhjet plenare.

3. Shqyrtimi i mocioneve, të rekomandimeve dhe të kërkesave

3.1 Shqyrtimi i kërkesës së deputetit Nait Hasani për debat për dënimin e krimeve të komunizmit në Kosovë

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës diskutuan: Jakup Krasniqi, Ibrahim Makolli, Ramë Buja, Sabri Hamiti dhe Nexhat Daci, që janë paraqitur në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverbali.

Kryesia, pasi shqyrtoi këtë pikë të rendit të ditës, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Kërkohet nga kryetarët e grupeve parlamentare që të harmonizojnë tekstin e Propozim - Rezolutës për dënimin e krimeve të komunizmit në Kosovë, për periudhën 1945-1990, dhe për këtë ta njoftojnë Kryesinë e Kuvendit, për procedim të mëtejshëm.

3.2 Dërgimi për mendim Qeverisë së Kosovës i Projektligjit për Komisionin e Pavarur për Media dhe Transmetim, hartuar nga Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media

Kryesia, pasi shqyrtoi këtë pikë të rendit të ditës, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

1. Kërkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të japë mendim lidhur me Projektligjin për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe Transmetim, hartuar nga Komisioni parlamentar për Administratë Publike, Pushtet Lokal, dhe Media.
2. Kërkohet nga Ministria për Ekonomi dhe Financa që të bëjë verifikimin e ndikimit buxhetor të këtij projektligji.
3. Qeveria të paraqesë mendimin e vet me shkrim në afatin prej një muaji, nga dita e pranimit të Projektligjit, së bashku me Deklaratën për verifikimin e ndikimit buxhetor. Pas kalimit të këtij afati, Projektligji procedohet në Kuvend, për shqyrtim.

3.3 Shqyrtimi i shkresës së Agjencisë Kundër Korrupsionit lidhur me konfliktin e interesit të deputetit Fatmir Rexhepi

Kryesia, pasi shqyrtoi këtë pikë të rendit të ditës, konstatoi se deputeti Fatmir Rexhepi ka ofruar një njoftim shtesë lidhur me këtë rast dhe vendosi që të njejtin t’ia dërgojë Agjencionit Kundër Korrupsionit, me qëllim të verifikimit të gjendjes faktike.

3.4 Shqyrtimi i kërkesës së Grupit parlamentar “7+” për marrjen e masave ndaj deputetit Numan Baliq

Kryesia, pasi shqyrtoi këtë pikë të rendit të ditës, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Në bazë të nenit 65, paragrafi 6, (i cili ndërlidhet me nenin 41 paragrafi 1) të Rregullores së Kuvendit: *“Dispozitat për kryetarin e komisionit zbatohen në përshtatje me dispozitat për autoritetin e Kryetarit të Kuvendit”*.

Sipas kësaj dispozite, kryetari i Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve është dashur të ndër marrë masat e parapara me nenin 41 paragrafi 1. të Rregullores së Kuvendit.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 11:50 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:
Divizioni për çështje plenare dhe procedurale